



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS (OIK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.12 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Neni 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.12 të Statutit të Odës së Infermierëve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË ANËTARËSISË

1. Taksa e anëtarësisë për të gjithë të punësuarit në sistemin publik paguhet në shumën prej 0.5% nga paga bruto dhe e njëjta inkasohet nga sistemi i pagesave *Payroll* (Ministria e Financave – Thesari i Kosovës).
2. Anëtarët e papunë, të punësuarit në sektorin privat paguajnë anëtarësinë në shumën prej 3 euro në muaj.
3. Anëtarët e OIK që kanë statusin e pensionerit paguajnë anëtarësinë në shumën prej 2 (dy) euro në muaj.
4. Pagesa e anëtarësisë për anëtarët e OIK nga pika 2 dhe 3 e këtij vendimi bëhet në baza vjetore.
5. Mos përmbushja e këtij obligimi për më shumë se 6 muaj do të ketë për pasojë inicimin e procedurës disiplinore në pajtim me ligjet në fuqi.
6. Çdo ngecje në pagesë do të ketë për pasojë çregjistrimin nga regjistri i anëtarëve dhe revokimin e licencës, sipas Rregullores për Anëtarësim, neni 10 dhe 11.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen pikat 1.2 dhe 1.3 të Vendimit me nr. prot. 144, të datës 01.03.2022.

I' dërgohet:

- Zyrës Ligjore
- Zyrës së Anëtarësisë
- Zyrës së Financave
- Zyrës së IT-së
- Arkivit

Kryetarja e OIK

Nexhmije Gori

